



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL. Anr.215/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci, Gyltene Sylejmani dhe Hasan Shala anëtarë, si dhe me pjesmarjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e organizatës BIRN dhe Internews Kosova me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, për shkak të përdorimit të të miturve në fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 16.10.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**PRANOHET** si e bazuar ankesa e organizatës BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë i shqiptohet dënim me gjobë në vlerë prej 3,100.00 (tremijë e njëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

## A r s y e t i m

Organizata BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP, me datën 13.10.2017, me të cilën pretendon se me datën 12.10.2017 kandidati për kryetar të Komunës së Ferizajit, Muharrem Svarqa nga radhët e subjektit politik LDK pretendohet se ka shkelur Rregullën Nr. 13/2013, Neni 5.2. duke përfshirë fëmijë në tubimin zgjedhorë të mbajtur në një shkollë në fshatin Rahovicë të Komunës së Ferizajt. Më tej kanë shtuar se nga disa foto të publikuara në faqen e tij në Facebook kandidati shihet në foto me këta persona të mitur dhe prezenca e tyre nuk mund të jetë e rastësishme ngase disa foto prej tyre vërehen të veshur me bluza me shenja identifikuese të subjektit LDK.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 14.10.2017, subjekti politik LDK, thekson se ankesën e BIRN dhe IKS të bërë ndaj subjektit të tyre e konsideron si të pabazuar sepse sipas fotove të bashkangjitura në ankesë personat që shihen në foto janë të rritur dhe nuk mund të trajtohen si të mitur nën moshën 18 vjeçare. Po ashtu kanë theksuar se shtabi zgjedhorë i LDK-së në Ferizaj e konfirmon se me siguri nuk kishte persona të mitur në tubim, dhe se pavarësishtë kësaj fotot janë larguar nga rrejtet sociale për të mos krijuar hapsirë për keqkuptim.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, jeti se:

### Ankesa është e bazuar

Paneli nga dëshmitë e ofruara nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se, kandidati për kryetar të Komunës së Ferizajit, Muhammed Svarqa nga radhët e subjektit politik LDK ka përdorur fëmijë në fushatë, veprim që është në kundërshtim me nenin 5.2 të Rregullës Zgjedhore nr. 13/2013 të KQZ-së e cila përcakton: “Në fushatën e zgjedhjeve të asnjë subjekti politik të certifikuar nuk mund të përfshihen personat që nuk i kanë mbushur 18 vjet”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondevë të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.


Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës LDK, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtë janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen ka mohuar shkeljen e supozuar duke theksuar se personat që shihen në foto janë të rritur dhe nuk mund të trajtohen si të mitur nën moshën 18 vjeçare. Rrethana këto të cilat kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi. Paneli po ashtu vlerësoi se dënim i shqiptuar ndaj subjektit në fjalë do të ndikoj që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar në nenin 117 dhe 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

ZL.Anr.215/2017 me datë 16.10.2017.

**Kryesues i Panelit**  
Adrian Konushhevci



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.